



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDËRMARRJA E PASTRIMIT FIER

Nr. ____/____Prot.

Fier, më 29.05.2023

Lënda: Formulari i njoftimit paraprak të fituesit për procedurën me objekt “Blerje mjete teknologjike për nevojat e Ndërmarrjes së Pastrimit Fier” (*Kamiona teknologjik për mbetjet urbane (kompaktor)*), me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes se Pastrimit Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 10

NDËRMARRJA E PASTRIMIT FIER

Data: 29.05.2023

Drejtuar: Operatorit ekonomik “KOMBI INVEST” SHPK

Adresa: Fier Fier FIER BISHANAK
K43407402P

*** * ***

Procedura e prokurimit: E hapur me mjete elektronike, me objekt “Blerje mjete teknologjike për nevojat e Ndërmarrjes së Pastrimit Fier” (*Kamiona teknologjik për mbetjet urbane (kompaktor)*),

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-67704-04-28-2023.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje mjete teknologjike për nevojat e Ndërmarrjes së Pastrimit Fier” (*Kamiona teknologjik për mbetjet urbane (kompaktor)*), me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **12 000 000 (dymbëdhjetë milion) lekë pa TVSH**, me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes se Pastrimit Fier, në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [08 Maj 2023], [Numri 41].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- ❑ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ❑
- ❑ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “GERARD – A” SHPK me numër NUIS L12407005L. Vlera totale sipas shtojcës 1 ‘Formulari I Ofertës’ është 10 500 000 (dhjetë milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh. - afati i dorezimit sipas kërkesës së bërë.
2. Operatori ekonomik “KOMBI INVEST” SHPK me numër NUIS K43407402P. Vlera totale sipas shtojcës 1 ‘Formulari I Ofertës’ është 10 800 000 (dhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh. - afati i dorezimit sipas kërkesës së bërë.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

Operatori ekonomik GERARD – A SHPK me NUIS L12407005L

Bazuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, **2.KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT** pika 2.3.2, për përmbushjen e këtij kriteri **Operatori Ekonomik Ofertues** duhet të paraqesë katalog Teknik ose skedë teknike për mjetin, i cili/ e cila minimalisht të përmbajë një përshkrim të karakteristikave teknike dhe të dhënave të tjera në lidhje me marken, vendin e origjinës, vitin e prodhimit, etj të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor përkatësisht sipas shtojcës 5 [Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor] formulari i specifikimeve teknike.

[Nese materiali/et te cilat do te paraqiten per te permbushur kriterin e mesiperme jane ne gjuhe te huaj, ato duhet te perkthehen ne shqip per pjesen e te dhenave teknike te kerkuara si dhe te noterizuara].

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara

Nga ana e operatorit ekonomik GERARD – A SHPK me NUIS L12407005L është paraqitur në SPE për përmbushjen e kriterit të mësipërm, dokumentacion i emërtuar Fier.pdf, i cili përmban fotokopje të dokumentacionit të noterizuar, për të cilin para noterit publik, bazuar në vërtetimin e përkthimit NR.REP 4978, datë 21/03/2023, është paraqitur përkthyesja e cila ka kërkuar përkthimin dhe noterizimin e këtij dokumentacioni dhe jo subjekti ekonomik GERARD - A SHPK si operatori ekonomik ofertues.

KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar sipas kriterëve ligjore të DST-së ku nga Operatori ekonomik **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, çka përbën shkak për skualifikim.**

Nga ana e operatorit ekonomik GERARD – A SHPK KVO pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e emërtuar Fier.pdf, me të dhënat teknike për tre mjete, konstaton se në një prej mjeteve lënda djegëse është “kriogjenik” dhe jo lëndë djegëse “naftë”, siç është përcaktuar në specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor për përmbushjen e objektit të prokurimit **“Blerje mjete teknologjike për nevojat e Ndërmarrjes së Pastrimit Fier” (Kamiona teknologjik për mbetjet urbane (kompaktor)”,** Mosplotësimi qoftë edhe i një specifikimi teknik të vendosur nga Autoriteti Kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. **çka përbën shkak për skualifikim.**

Këto arsye përbëjnë shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **KOMBI INVEST SHPK**, numri i NUIS: **K43407402P**, me adrese: Fier Fier FIER BISHANAK, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **10 800 000** (dhjetë milion e tetëqind mijë) **lekë pa tvsh** dhe **12 960 000** (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) **lekë me tvsh**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Konc:Njesia e Prokurimit

J.Demiraj

E.Haxhiraj

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Fatjon ELEZAJ